



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 21

Datë 3 mars 2014

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 61, datë 12.2.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të Tiranës së Madhe”..... 437
Vendim i KM nr. 63, datë 12.2.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar 440
Vendim i KM nr. 64, datë 12.2.2014	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të zyrave, nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, te Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale..... 443
Vendim i KM nr. 66, datë 12.2.2014	Për përcaktimin e kriteve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, si punonjës me kualifikim të lartë, të tipit “A/KL” 444
Vendim i KM nr. 67, datë 12.2.2014	Për përcaktimin e kriteve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës, për shërbime kontraktuese, të tipit “C/SHK”..... 449
Vendim i KM nr. 68, datë 12.2.2014	Për përcaktimin e kriteve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës, si punëtor shtëpiak, të tipit “A/PSH” 454

Vendim i KM nr. 69, datë 12.2.2014	Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së përhershme të punës, të tipit “D”	459
Vendim i KM nr. 70, datë 12.2.2014	Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me certifikatë regjistrimi në punë	464
Vendim i KM nr. 72, datë 12.2.2014	Për identifikimin e sipërfaqes së tokës prej 25 000 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim njëjësive të qeverisjes vendore, e cila do të kalojë në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	468
Vendim i KM nr. 73, datë 12.2.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 7870, datë 13.10.1993 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, të ndryshuar	468
Vendim i KM nr. 74, datë 12.2.2014	Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, për shërbime vullnetare, të tipit “A/SHV”	470
Vendim i KM nr. 75, datë 12.2.2014	Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, si punëtor stinor, të tipit “A/PS”	475
Vendim i ERE nr. 6, datë 30.1.2014	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., për transferimin e aseteve të HEC “Ulëz”-“Shkopet”, “Bistrica 1” dhe “Bistrica 2” në kuadër të marrëveshjes me “IFC”	479
Vendim i ERE nr. 7, datë 6.2.2014	Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Kurum International sh.a.”, për transferimin e aseteve të HEC “Ulëz”-“Shkopet”, “Bistrica 1” dhe “Bistrica 2” në kuadër të marrëveshjes me “IFC”, “Banka Kombëtare Tregtare sh.a.”, “Black Sea Trade and Development Bank” and “Raiffeisen Bank sh.a”	480
Vendim i ERE nr. 8, datë 6.2.2014	Për shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 144, datë 22.11.2013 “Mbi pezullimin e procedimit të transferimit të licencës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Wonder Power” sh.a. te shoqëria “BHP Energy” sh.p.k.	481
Vendim i ERE nr. 9 datë 6.2.2014	Mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”	481
Vendim i ERE nr. 10, datë 6.12.2013	Mbi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë	481
Vendim i ERE nr. 11, datë 6.2.2014	Për fillimin e procedurave për rinovimin e licencës së shoqërisë “KESH” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	482

VENDIM
Nr. 61, datë 12.2.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT
“PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT
TË TIRANËS SË MADHE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të Tiranës së Madhe”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë bujqësore me sipërfaqe 148 971 (njëqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) m², vlerësuar me çmimin konfirmuar nga AKKP-ja prej 448 (katërqind e dyzet e tetë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 66 739 008 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 240 000 (një milion e dyqind e dyzet mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve.

5. Vlera totale e shpronësimin, prej 66 739 008 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2014 për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë (certifikatë, hartë kadastrale dhe kartelë të rifreskuar), që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 5, 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimin që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS (DPUK)
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË KONFIRMUAR PËR SHPRONËSIM, TË CILËT PREKEN NGA NDËRTIMI I
"IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA", KASHAR

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas	Volumi	Faqe	Lloji i tokës	Sip. e përgj.	Sip. për shpronësim	Çmimi	Vlera e kompensimit	Shënime
									m ²	m ²	lekë/m ²	lekë	
1	Sherif	Qerim	Sorra	3866	121/1	1	147	arë	8400	7583	448	3397184	Konfirmuar
2	Kujtim		Mulleti	3866	122/3	1	153	arë	5900	1924	448	861952	Konfirmuar
3	Gani	Musa	Shima	3866	137/3	1	187	arë	4800	1876	448	840448	Konfirmuar
4	Rasim, Irakli, Avni dhe Niko	Isuf	Nela	3866	138/1/1	1	193	arë	3500	623	448	279104	Konfirmuar
5	Islam	Hysen	Bodlli	3866	138/1/2	1	194	arë	3125	513	448	229824	Konfirmuar
6	Ismail , Xhemile, Drita, Zenepe, Shpresa, Vaje, Ervin, Ermira, Ada	Hasan Hasan Mustafa Shyqyri Ismail Ismail Ismail	Bodlli Bodlli Alushi (Bodlli) Likaj (Bodlli) Bodlli Bodlli Bodlli Bodlli Bodlli	3866	138/1	1	192	arë	3000	356	448	159488	Konfirmuar
7	Izet	Xhemal	Roshi	3866	138/7	25	57	arë	5000	379	448	169792	Konfirmuar
8	Sabri	Reshit	Bakalli	3866	116/7/3	1	136	arë	6000	342	448	153216	Konfirmuar
9	Selam	Xhemali	Visha	3866	123/18	10	226	arë	7500	7500	448	3360000	Konfirmuar
10	Sherif	Xhemali	Visha	3866	123/17	10	225	arë	6000	6000	448	2688000	Konfirmuar
11	Qazim	Xhemali	Visha	3866	123/16	10	224	arë	6000	6000	448	2688000	Konfirmuar
12	Agim	Hasan	Shehu	3866	123/12	1	176	arë	9470	9470	448	4242560	Konfirmuar
13	Zydi	Xhelal	Kodra	3866	202/3/1	33	159	arë	4800	4800	448	2150400	Konfirmuar
14	Nikolle	Zef	Tushaj	3866	202/3/2	33	160	arë	1000	1000	448	448000	Konfirmuar
15	Beqir	Ali	Haklaj	3866	203/12	63	186	arë	500	500	448	224000	Konfirmuar
16	Hedie, Joana, Marita, Arlind, Elton		Tahiri, Tahiri Tahiri, Karameta Tahiri	3866	203/13	63	187	arë	4500	3074	448	1377152	Konfirmuar
17	Ymer	Ibrahim	Gresa	3866	204/13	32	170	arë	3400	3400	448	1523200	Konfirmuar
18	Shoqëria "Vagalat" sh.p.k.			3866	204/14	32	171	arë	5000	5000	448	2240000	Konfirmuar
19	Sali	Ali	Shehu	3866	181/4	10	145	arë	2400	2400	448	1075200	Konfirmuar
20	Imer	Mal	Baji	3866	181/5	10	146	arë	1600	1600	448	716800	Konfirmuar
21	Lazan	Uke	Peposhi	3866	181/7	10	148	arë	2400	2400	448	1075200	Konfirmuar
22	Muhamed	Sabri	Hasmuca	3866	181/8	10	149	arë	4000	4000	448	1792000	Konfirmuar
23	Anila	Qazim	Qefalia	3866	181/9	10	150	arë	3200	3200	448	1433600	Konfirmuar
24	Hasan	Ibrahim	Abdyli	3866	181/10	10	151	arë	5600	5600	448	2508800	Konfirmuar
25	Reshit	Sabri	Hasmuca	3866	181/10/1	10	152	arë	3200	3200	448	1433600	Konfirmuar
26	Qemal	Qazim	Bega	3866	181/11	10	153	arë	4000	4000	448	1792000	Konfirmuar
27	Arben	Faslli	Cerpja	3866	181/12	10	154	arë	2400	2400	448	1075200	Konfirmuar

28	Ramazan	Ahmet	Byku	3866	181/15	10	157	arë	3200	3200	448	1433600	Konfirmuar
29	Taip	Ahmet	Mirashi	3866	181/16	10	158	arë	6400	6400	448	2867200	Konfirmuar
30	Haxhi	Beqir	Kabili	3866	181/24	24	96	arë	4000	2883	448	1291584	Konfirmuar
31	Halil	Sulejman	Elezi	3866	181/25	24	97	arë	5600	5600	448	2508800	Konfirmuar
32	Mexhit		Lita	3866	181/26	24	142	arë	2500	2500	448	1120000	Konfirmuar
33	Flamur		Lamaj	3866	181/10	22	134	arë	1800	1612	448	722176	Konfirmuar
34	Bukurie		Beqiri	3866	181/9	22	149		2500	1323	448	592704	Konfirmuar
35	Mitat	Neki	Durmishi	3866	193/3	10	169	arë	3200	1950	448	873600	Konfirmuar
36	Neki	Halit	Dervishi	3866	193/14	10	180	arë	9600	5000	448	2240000	Konfirmuar
37	Aferdita		Dajti	3866	193/15	25	241	arë	7000	640	448	286720	Konfirmuar
38	Fatmir	Qazim	Karaj	3866	193/17	26	93	arë	6700	80	448	35840	Konfirmuar
39	Hysen	Haxhi	Zhllima	3866	193/20	26	197	arë	1000	1000	448	448000	Konfirmuar
40	Fadil	Hysen	Koci	3866	193/24	41	160	arë	3000	3000	448	1344000	Konfirmuar
41	Arben	Seit	Duma	3866	195/1	10	186	arë	3200	2138	448	957824	Konfirmuar
42	Ilmi	Faslli	Cerpja	3866	195/3	10	188	arë	3200	1574	448	705152	Konfirmuar
43	Telha	Mersin	Loçka	3866	195/4	10	189	arë	3200	1655	448	741440	Konfirmuar
44	Saba	Mustafa	Peshku	3866	195/5	10	190	arë	7200	3938	448	1764224	Konfirmuar
45	Teferrri	Çerqez	Pashaj	3866	195/6	10	192	arë	800	480	448	215040	Konfirmuar
46	Gani	Qamil	Hoxha	3866	195/15	25	216	arë	1000	650	448	291200	Konfirmuar
47	Shfqet		Bruka	3866	195/8	10	194	arë	2400	1300	448	582400	Konfirmuar
48	Gezim	Qemal	Pashaj	3866	195/9	10	195	arë	3200	1557	448	697536	Konfirmuar
49	Shaqir	Daut	Beqiri	3866	195/10	10	196	arë	4800	3320	448	1487360	Konfirmuar
50	Xhemal	Halit	Gllava	3866	195/11	10	197	arë	6400	3750	448	1680000	Konfirmuar
51	Alfred	Taip	Mirashi	3866	195/12	10	198	arë	4000	3081	448	1380288	Konfirmuar
52	Aleksander dhe Taship	Bajram	Lluka	3866	195/13	10	199	arë	1500	1200	448	537600	Konfirmuar
										148971		66739008	

VENDIM
Nr. 63, datë 12.2.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË
VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE
CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT
DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË
KRYEMINISTRIN, APARATET E MINISTRIVE
TË LINJËS, ADMINISTRATËN E
PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË
E PËRGGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË
PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË
KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË
VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE
ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në lidhjen nr. 3, që përmendet në pikën 3, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Ndarjet “Kryeministria”, “Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, “Ministria e Punëve Publike dhe Transportit” dhe “Avokati i Prokurimeve”, shfuqizohen;

- Në ndarjen “Ministria e Brendshme”, emërtesa “Koordinator në Departamentin e Administratës Publike”, shfuqizohet.

b) Pas lidhjes nr. 3 shtohet lidhja nr. 3/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pika 4/2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/2. Në Kryeministri, pozicionet “Drejtor i Departamentit të Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit” dhe “Drejtor i Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj”, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj, pozicionet “Drejtor njësie, jurist, koordinator dhe inspektor në Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit” dhe “Drejtor njësie, drejtor drejtorie dhe koordinator në Departamentin e Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj”, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.”.

ç) Lidhja nr. 6/8, që përmendet në pikën 10/8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Tabela I “Për Teatrin Kombëtar dhe Drejtorinë Artistike të Teatrit të Operas dhe Baletit në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor”, e lidhjes nr. 7/1, që përmendet në pikën 11/1, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

dh) Lidhja nr. 9, që përmendet në pikën 13, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

e) Lidhja nr. 9/4, që përmendet në pikën 13/4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për nëpunësit për institucionet përkatëse të fillojnë:

a) Për parashikimin e tabelës I të lidhjes nr. 7/1, nga data 15 korrik 2013;

b) Për të gjitha parashikimet e tjera, nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRIN
Edi Rama

Lidhja nr. 3/1

KATEGORIZIMI PËR POZICIONET E VEÇANTA TË PUNËS PËR FUNKSIONET E VEÇANTA NË KRYEMINISTRI DHE DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE

INSTITUCIONI	POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS
Kryeministria	Drejtor njësie	II-a
	Jurist Inspektor Koordinator	II-b
	Departamenti i Administratës Publike	III-a
	Koordinator	

Lidhja nr. 6/8

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT DOGANOR

Klasifikimi doganor	Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit	Shtesa e pozicionit	
				Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
	Titullar i institucionit	II-a	1		20000
	Zv/drejtor i përgjithshëm	II-b	1		15000
A	Këshilltar. Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Kakavijë, Rinas	III-a	1		15000
B	Përgjegjës/Shef sektori. Kryetar dege doganore Fier, Kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë-Thanë, Elbasan. Përgjegjës operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës	III-a/1	1		14000
C1	Inspektor kontrolli i brendshëm. Përgjegjës turni. Përgjegjës zyre. Komandant grupi antikontrabande. Specialist. Administrator rrjeti	III-b	1 ose 2		14000
	Financier në degë doganore , Përkthyes, Koordinator në DOH, Specialist i marrëdhënieve ndërkombëtare	III-b	1 ose 2		10000
C2	Specialist. Doganier kontrolli dokumentar, fizik. Inspektor antikontrabande. Asistent laborator. Llogaritar	IV-a	1 ose 2 ose 3		10000
C3	Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretar. Arkivist.			37000	5000
D1	Magaziner. Furnitor. Operator. Shofer. Teknik			32000	1500
D2	Punëtor mirëmbajtës			Klasa IV (sipas vendimit të këshillit të ministrave për pagat e punonjësve mbështetës)	
D3	Punonjës pastrimi			Klasa I (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës)	

Lidhja nr. 7/1**I. PËR TEATRIN KOMBËTAR DHE DREJTORINË ARTISTIKE TË TEATRIT TË OPERËS DHE
BALETIT NË TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR**

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor Solist i parë Koncertmaestër Baletmaestër Aktor i parë Solist II (spala sektori)	79.200 lekë
2	Solist II (lirikë, baleti pianistë) Spalë kori	73.200 lekë
3	Asistent dirigjent Asistent regjisor Aktor i dytë Orkestrant i kategorisë së parë	71.000 lekë
4	Korist i kategorisë së parë Balerin i kategorisë së parë Skenograf i kategorisë së parë	59.800 lekë
5	Aktor i tretë	58.300 lekë
6	Orkestrant i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Balerin i kategorisë së dytë Skenograf i kategorisë së dytë	49.500 lekë

Lidhja nr. 9

**KATEGORITË E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET RAJONALE/VENDORE, NË VARËSI TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT, MINISTRAVE TË LINJËS, TË INSTITUCIONEVE
RAJONALE/VENDORE NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE TË PËRCAKTUARA NË PIKËN 1, TË
INSTITUCIONEVE VENDORE NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE RAJONALE, TË PUNONJËSVE QË KRYEJNË
FUNKSIONE TË DELEGUARA TË PUSHTETIT QENDROR NË PUSHTETIN VENDOR, TË BORDEVE TË
KULLIMIT, TË KOMISIONEVE VENDORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË
TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE, PRANË PREFEKTIT TË QARKUT**

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit rajonal Kryetar i Zyrës së Përmbartimit Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Përgjegjës i degëve të thesarit në qendër qarku Përgjegjës seksioni në seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qarqe Kryeinspektor në inspektoratet e mbrojtjes së tokës në qarqe	III-b	1
Titullar i institucionit vendor Përgjegjës i zyrës rajonale Përgjegjës sektori në institucionet rajonale Përgjegjës sektori në drejtoritë e bujqësisë Përgjegjës sektori në Degën e Thesarit Tiranë Përgjegjës të degëve vendore të thesarit Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Përgjegjës i gjendjes civile pranë prefektit Inspektorë të sistemit të Ministrisë së Bujqësisë	IV-a	1
Përmbartues Gjyqësor në zyrat e përmbartimit gjyqësor Specialist në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës	IV-a	1 ose 2 ose 3

Përgjegjës sektori i institucionit vendor Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar)	IV-b	1
Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Specialist në drejtoritë e bujqësisë Specialist i gjendjes civile pranë prefektit Specialist në institucionet rajonale Restaurator arti Arkitekt Inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës në qarqe Specialist në degët e thesarit Inspektor pune	IV-b	1 ose 2 ose 3
Specialist në institucionet vendore Specialist i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar) Restaurator Instruktor Piktor Kontrollor pune	IV-c	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 9/4

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT "SPECIALIST" DERI NË "TITULLAR INSTITUCIONI" NË DREJTORITË E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONA VE/NDËRTIMEVE INFORMALE

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit	Shtesa për kushte pune
Drejtor i drejtorive të ALUIZNI-t: Tiranë 1, Tiranë 3, Shkodër, Durrës, Lezhë, Vlorë, Elbasan, Fier, Korçë, Berat	III-a/1	1	16.500
Drejtor i drejtorive të ALUIZNI-t: Tiranë 2, Gjirokastrë, Dibër, Kukës	III-b	1	16.500
Përgjegjës sektori	IV-a	1	10.000
Specialist	IV-b	1 ose 2 ose 3	10.000

VENDIM

Nr. 64, datë 12.2.2014

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË ZYRAVE, NGA
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE SHITJES
SË PRONAVE PUBLIKE, NË MINISTRINË E
FINANCIVE, TE KOMISIONERI PËR
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të zyrave në katin e pestë të godinës së ish-shtëpisë botuese "Naim Frashëri", Tiranë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi

të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, te Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për t'u përdorur si mjedise pune nga ky institucion.

2. Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen ministri i Financave, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe kryeregjistruesi i Zyrës për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM
Nr. 66, datë 12.2.2014

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN, REFUZIMIN DHE ANULIMIN E LEJES SË PUNËS, SI PUNONJËS ME KUAKIFIKIM TË LARTË, TË TIPIT "A/KL"¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, 86, pika 2, dhe 105, pika 1 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e tipit "A/KL", si punonjës me kualifikim të lartë, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka një kontratë pune me një punëdhënës, në përputhje me formimin e tij profesional për një profesion, për të cilin kërkohen cilësi dhe kualifikim i veçantë, me kohëzgjatje së paku 2-vjeçare në Republikën e Shqipërisë;

b) ka hyrë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, që do të thotë me vizë, sipas llojeve të përcaktuara në nenet 21 e 22 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt";

c) plotëson kushtet e përcaktuara në legjislacionin kombëtar në fuqi për ushtrimin e një profesioni të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, të specifikuar në kontratën e punës;

ç) për profesionet e parregulluara, nëse paraqet dokumentet që vërtetojnë kualifikimet e larta profesionale në profesionin apo sektorin e specifikuar në kontratën e punës;

d) nëse paga minimale e përcaktuar në kontratën e tij të punës me punëdhënësin është sa trefishi i pagës minimale bruto mujore, e përcaktuar sipas legjislacionit kombëtar në fuqi.

2. Të huajt i ripërtërihet leja e punës e tipit "A/KL", si punonjës me kualifikim të lartë, për një afat 3-vjeçar, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka një kontratë pune të vlefshme, në përputhje me formimin e tij profesional, për një afat 3-vjeçar, por jo domosdoshmërisht me punëdhënësin, që ka përfituar lejen e parë të tipit "A/KL";

b) plotëson kushtet e shkronjave "c", "ç" dhe "d" të pikës 1 të këtij vendimi;

c) është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

3. Kërkesa për t'u pajisur me leje pune të tipit "A/KL" bëhet nga:

a) i huaji;

b) punëdhënësi, me të cilin i huaji ka një kontratë pune;

c) personi i autorizuar nga punëdhënësi.

4. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për t'u pajisur për herë të parë me leje pune të tipit "A/KL", paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajt me të dhënat personale, sipas formatit të dhënë në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) vendimin e gjykatës për regjistrimin e personit juridik ose ekstraktin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për punëdhënësin, ku ai do të punësohet;

c) kopjen origjinale të kontratës individuale të punës, ku të plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi;

ç) dokumente që vërtetojnë kualifikimet e larta profesionale në profesionin apo sektorin e përcaktuar në kontratën e punës;

d) kopjen e pasaportës;

dh) autorizimin nga punëdhënësi për personin e autorizuar;

e) pesë fotografi.

5. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për t'u pajisur me leje pune të ripërtëritur të tipit "A/KL", paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajt me të dhënat personale;

b) kopjen e kontratës individuale të punës me afatin kohor të përcaktuar deri në tre vjet;

c) autorizimin nga punëdhënësi për personin e autorizuar;

ç) pesë fotografi.

6. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikat 4 e 5 të këtij vendimi, në:

a) zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, ushtron veprimtarinë ekonomike dhe nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik dhe nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e tij të origjinës ose pranë përfaqësisë diplomatike që mbulon vendin e tij të origjinës.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, kur kërkesa paraqitet pranë tyre, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me

¹ Ky vendim i Këshillit të Ministrave përafrohet me direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009 "Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar". Numri CELEX 32009L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian.

kërkesat e pikës 4 të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës nga personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, verifikon shlyerjen e detyrimeve lidhur me pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit, pranë të cilit do të punësohet i huaji.

9. Nëse Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, vlerëson se dokumentacioni i paraqitur është i plotë apo pas plotësimit të tij nga personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, brenda afatit të përcaktuar, përmbush kriteret e përcaktuara në pikat e këtij vendimi, e pajis të huajin, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune me leje pune të tipit "A/KL", për herë të parë, sipas formatit të dhënë në aneksin 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune të tipit "A/KL" punëmarrësit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 8 të këtij vendimi, ose është në kushtet e parashikuara në pikën 21 të këtij vendimi.

12. Nëse kërkesa është paraqitur pranë përfaqësuesit diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit, kjo e fundit, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, ia përcjell dokumentacionin drejtorisë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

13. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet drejtorisë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, e përcjell dokumentacionin e paraqitur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrën përkatëse të punësimit, sipas kompetencës territoriale që ato kanë.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, për pajisjen/refuzimin e të huajit të lejes së punës të tipit "A/KL", ndjek procedurat e përcaktuara në pikat 7, 8, 9, 10 e 11 të këtij vendimi.

15. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, nëpërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e përcjell në Ministrinë e Punëve të Jashtme njoftimin për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit "A/KL".

16. Ministria e Punëve të Jashtme njofton përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit, për pajisjen/refuzimin e lejes së

punës të tipit "A/KL".

17. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për ripërtëritjen e lejes së punës të tipit "A/KL", paraqesin, 30 (tridhjetë) ditë para mbarimit të afatit të lejes ekzistuese, kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, në:

a) zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, ushtron veprimtarinë ekonomike;

b) Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik.

18. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, për ripërtëritjen e lejes së punës të tipit "A/KL" apo refuzimin e saj, brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, ndjek procedurat e parashikuara në pikat 7, 8, 9, 10 e 11 të këtij vendimi, ndërsa vlerësimi për kriteret dhe dokumentacionin bëhet sipas përcaktimeve në pikat 1, 2, 5, 8 e 21 të këtij vendimi,

19. Të huajit i refuzohet lëshimi i lejes së punës të tipit "A/KL" apo ripërtëritja e saj edhe nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në nenin 77 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

20. Të huajit i anulohet leja e punës e tipit "A/KL", nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 80 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

21. I huaji, të cilit i refuzohet ose i anulohet leja e punës e tipit "A/KL", ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 81 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

22. Leja e punës e tipit "A/KL" përfundon, nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 78 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

23. I huaji, i cili pajiset me leje pune të tipit "A/KL" për herë të parë, para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 6 000 (gjashtë mijë) lekësh.

24. I huaji, të cilit i ripërtërihet leja e punës e tipit "A/KL" për herë të parë, para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 3 000 (tri mijë) lekësh.

25. Drejtoria, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për dhënien e lejes së punës.

26. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË



REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF SOCIAL
WELFARE AND YOUTH

DREJTORIA E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE MIGRATORE

EMPLOYMENT AND MIGRATION POLICIES DIRECTORATE
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT
NATIONAL EMPLOYMENT SERVICE

FORMULAR-KËRKESË / APPLICATION

për lëshimin e lejes së punës një të huaji/for issuance of work permit to a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT/INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit _____
Name of the employer

2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit _____
Seat and address of the employer

3. Numri i regjistrimit në ISSH |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Registration number in the Cr Health Insurance Institute

4. Kodi fiskal NIPT |__|__|__|__|__|__| **OIB** |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Business activity code

a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment or

b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit: _____
Abstract from National Registration Centre

5. Data e menduar e fillimit dhe e përfundimit të punës |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| deri në
|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Period for which the work permit is requested from to

6. Emërtimi i vendit të punës _____
Name of the job position

7. Kuotat vjetore **PO JO**
Yearly quota **YES NO**

8. Punësimi sezonal **PO JO**
Seasonal employment **YES NO**

9. Migrimi ditor **PO JO**
Daily migration **YES NO**

2. TË DHËNAT E TË HUAJIT/INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mbiemri _____
Surname
2. Emri _____
Given name(s)
3. Emri i babait _____
Name of the parent
4. Datëlindja |__|__|__|__|__|__|__|__|
Date of birth
5. Gjinia **F M** |__|__|__|__|__|__|__|__|
Sex **M F*** to be entered if issued
6. Vendi dhe shteti i lindjes _____
Place and country of birth
7. Shtetësia _____
Nationality
8. Adresa e banimit në Shqipëri _____
Residential address in the Republic of Albania
9. Kodi dhe emri i punësimit |__|__|__|__|__|__|__|__| _____
Code and name of occupation
10. Kualifikimet |__|__|__|
Skill qualifications
11. Aktivitet fitimprurës **PO JO**
Gainfully employed **YES NO**

3. DOKUMENTI I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit _____
Type of document
2. Numri |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Number
3. Lëshuar në |__|__|__|__|__|__|__|__|
Issued on
4. E vlefshme deri më |__|__|__|__|__|__|__|__|
Valid until
5. Autoriteti kompetent _____
Competent authority
6. Lëshuar nga _____
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
(Applicant)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT

Nr. ____ prot.

Datë

LEJE PUNE PËR TË HUAJ

TIPI:

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr., datë __.__.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me leje pune”,

Z./znj. _____
Mr/Ms (emri, mbiemri / Given name(s) Surname)

FOTOGRAFIA / PHOTO

Lindur më _____
Born on (data, muaji, viti / Day Month Year)

Në _____
In (vendlindja / Place and country of birth)

Gjendja civile _____
(Civil Status)

Me shtetësi _____
Nationality

Me profesion _____
Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|

Type of document and number

I huaji pajiset me leje pune të tipit _____, pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në nenin të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj:
Name of the employer

Statusi i subjektit: _____
(Subject's Legal Status)

Spektori i aktivitetit: _____
(Sector of Activity)

Me adresë: _____
Seat and address

Vlefshmëria e lejes: _____
(Work Permit Validity)

Data e lëshimit: _____
(Issuance Date)

Data e skadimit: _____
(Expiration Date)

Pagesa:
(Application Fee)

Kjo leje pune është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në këtë kategori punësimi, bazuar në ligjin nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Institucioni lëshues:
(Issuing Authority)

DREJTOR

VENDIM
Nr. 67, datë 12.2.2014

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN, REFUZIMIN, RIPËRTËRITJEN DHE ANULIMIN E LEJES SË PUNËS, PËR SHËRBIME KONTRAKTUESE, TË TIPIT “C/SHK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, në zbatim të pikës 2 të nenit 86 dhe të pikës 1 të nenit 105 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e tipit “C/SHK”, për shërbime kontraktuese, për një kohëzgjatje jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një viti kalendarik, nëse plotëson kriteret, si më poshtë vijon:

- a) ka hyrë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 102 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”;
- c) ka një kontratë të rregullt pune për shërbime kontraktuese me punëdhënësin, përftues të shërbimeve, në Republikën e Shqipërisë për kategoritë e parashikuara në nenin 102 të ligjit nr. 108/2013.

2. Të huajt i ripërtërihet leja e punës e tipit “C/SHK”, për shërbime kontraktuese, nëse:

- a) bën pjesë në kategorinë e përcaktuar në pikën 5 të nenit 102 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”;
- b) ka një kontratë të rregullt pune, jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë për vitin në vazhdim, me një punëdhënës, përftues shërbimesh, por jo domosdoshmërisht me punëdhënësin e mëparshëm;
- c) punëdhënësi, i cili nuk është punëdhënësi i mëparshëm, nuk ka kryer shkelje të legjisllacionit të punës, në vitin kalendarik pararendës.

3. Kërkesa për t’u pajisur me leje pune të tipit “C/SHK”, bëhet nga:

- a) i huaji;
- b) punëdhënësi, përftues i shërbimeve, me të cilin i huaji ka një kontratë pune;
- c) personi i autorizuar nga punëdhënësi;

ç) përfaqësuesit e autoriteteve kompetente shtetërore, që marrin në mbrojtje kategoritë e përcaktuara në nenin 102 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

4. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për t’u pajisur për herë të parë me leje pune të tipit “C/SHK”, paraqesin dokumentacionin si më poshtë vijon:

- a) kërkesën e të huajt, me të dhënat personale, sipas formatit të dhënë në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) kopjen e kontratës individuale të punës, për kategoritë e përcaktuara në nenin 102 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”;
- c) kopjen e pasaportës së të huajt ofrues të shërbimeve;
- ç) pesë fotografi.

5. Personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, të cilët kërkojnë ripërtëritjen e lejes së punës të tipit “C/SHK”, për shërbime kontraktore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve para përfundimit të lejes paraardhëse paraqesin dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) kërkesën e të huajt, me të dhënat personale;
- b) kopjen e kontratës së punës, nëse ka ndryshuar punëdhënësi;
- c) kopjen e pasaportës së të huajt ofrues të shërbimeve;
- ç) pesë fotografi.

6. Personat e përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të tij, për pajisjen për herë të parë me leje pune ose në pikën 5 të këtij vendimi, në rast ripërtëritjeje të lejes së punës:

- a) në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, ushtron veprimtarinë ekonomike, nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse punëdhënësi pranë të cilit do të punësohet e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik, nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) pranë përfaqësuesit diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e tij të origjinës ose në përfaqësinë diplomatike që mbulon vendin e tij të origjinës.

7. Nëse kërkesa paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrës përkatëse të punësimit, autoriteti përkatës, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikave 4 ose 5 të këtij vendimi, i kërkon të huajt plotësimin e dokumentacionit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës nga personat e përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, verifikon shlyerjen e detyrimeve lidhur me pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit, pranë të cilit do të punësohet i huaji.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, nëse vlerëson se dokumentacioni i paraqitur është i plotë apo, pas plotësimit të tij brenda afatit të përcaktuar, nga personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 1 ose 2 të tij, e pajis të huajin me leje pune të tipit "C/SHK", sipas formatit të dhënë në aneksin 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, ose ia ripërtërin atë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia kthen të huajt kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune të tipit "C/SHK" ose ripërtëritjen e saj subjektivit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1 apo 2 të këtij vendimi ose është në kushtet e përcaktuara në pikën 17 të tij.

12. Nëse kërkesa është paraqitur pranë përfaqësuesit diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajt, ajo, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme (Qendrës Kombëtare të Vizave), e përcjell dokumentacionin e paraqitur pranë saj në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në drejtorinë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit.

13. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e përcjell dokumentacionin e paraqitur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrës përkatëse të punësimit, sipas kompetencës territoriale që ato kanë.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, për pajisjen/refuzimin e të huajt të lejes së punës të tipit "C/SHK", ndjek procedurat e përcaktuara në pikat 7, 8, 9, 10 e 11 të këtij vendimi.

15. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, nëpërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, përcjell në Ministrinë e Punëve të Jashtme njoftimin për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit "C/SHK".

16. Ministria e Punëve të Jashtme njofton përfaqësinë diplomatike të Republikës Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajt, për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit "C/SHK".

17. Anulimi ose refuzimi i lejes së punës të tipit "C/SHK" apo ripërtëritjes së saj bëhen kur i huaji është në njërën nga situatat e parashikuara në nenet 80, pika 1, dhe 81, pika 2 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

18. I huaji, të cilit i refuzohet ose i anulohet leja e punës e tipit "C/SHK", ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 81 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

19. Leja e punës e tipit "C/SHK" përfundon, nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 78 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

20. I huaji, i cili pajiset me leje pune të tipit "C/SHK" dhe i përket kategorive të përcaktuara në nenin 102 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 4 000 (katër mijë) lekësh.

21. I huaji, të cilit i rinovohet leja e punës e tipit "C/SHK" dhe i përket kategorisë së përcaktuar në pikën 5 të nenit 102 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 2 000 (dy mijë) lekësh.

22. Drejtoria që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për dhënien e lejes së punës.

23. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË**



**REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF SOCIAL
WELFARE AND YOUTH**

DREJTORIA E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE MIGRATORE

**EMPLOYMENT AND MIGRATION POLICIES DIRECTORATE
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT
NATIONAL EMPLOYMENT SERVICE**

FORMULAR-KËRKESË / APPLICATION

për lëshimin e lejes së punës një të huaji / for issuance of work permit to a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT / INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit _____
Name of the employer
2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit _____
Seat and address of the employer
3. Numri i regjistrimit në ISSH |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Registration number in the Cr Health Insurance Institute
4. Kodi fiskal NIPT |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| **OIB**|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Business activity code
 - a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment or
 - b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit: _____
Abstract from National Registration Centre
5. Data e menduar e fillimit dhe e përfundimit të punës |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| deri në
|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Period for which the work permit is requested from to
6. Emërtimi i vendit të punës _____
Name of the job position
7. Kuotat vjetore **PO JO**
Yearly quota **YES NO**
8. Punësimi sezonal **PO JO**
Seasonal employment **YES NO**
9. Migrimi ditor **PO JO**
Daily migration **YES NO**

2. TË DHËNAT E TË HUAJIT / INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mbiemri _____
Surname
2. Emri _____
Given name(s)
3. Emri i babait _____
Name of the parent

4. Datëlindja |__|__|__|__|__|__|__|__|
Date of birth

5. Gjinia **F M** |__|__|__|__|__|__|__|__|
Sex **M F*** to be entered if issued

6. Vendi dhe shteti i lindjes _____
Place and country of birth

7. Shtetësia _____
Nationality

8. Adresa e banimit në Shqipëri _____
Residential address in the Republic of Albania

9. Kodi dhe emri i punësimit |__|__|__|__|__|__|__|__| _____
Code and name of occupation

10. Kualifikimet |__|__|__|
Skill qualifications

11. Aktivitet fitimprurës **PO JO**
Gainfully employed **YES NO**

3. DOKUMENTI I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit _____
Type of document

2. Numri |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Number

3. Lëshuar në |__|__|__|__|__|__|__|__|
Issued on

4. E vlefshme deri më |__|__|__|__|__|__|__|__|
Valid until

5. Autoriteti kompetent _____
Competent authority

6. Lëshuar nga _____
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
(Applicant)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E MIRËQENIES
 SOCIALE DHE RINISË
 SHËRBIMI KOMBËTARI PUNËSIMIT

ANEKSI 2

Nr. ____ prot.

Datë

LEJE PUNE PËR TË HUAJ

TIPI:

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr., datë _____.2013 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me leje pune”,

Z./znj. _____
 Mr/Ms (emri, mbiemri / Given name(s) Surname)

FOTOGRAFIA / PHOTO

Lindur më _____
 Born on (data, muaji, viti / Day Month Year)

Në _____
 In (vendlindja / Place and country of birth)

Gjendja civile _____
 (Civil Status)

Me shtetësi _____
 Nationality

Me profesion _____
 Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____|____|____|____|____|____|____|____|____|____|

Type of document and number

I huaji pajiset me leje pune të tipit _____, pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në nenin të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj:
 Name of the employer

Statusi i subjektit: _____
 (Subject's Legal Status)

Spektori i aktivitetit: _____
 (Sector of Activity)

Me adresë: _____
 Seat and address

Vlefshmëria e lejes: _____
 (Work Permit Validity)

Data e lëshimit: _____
 (Issuance Date)

Data e skadimit:
(Expiration Date) _____

Pagesa:
(Application Fee) _____

Kjo leje pune është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në këtë kategori punësimi, bazuar në ligjin nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Institucioni lëshues:
(Issuing Authority) _____

DREJTOR

VENDIM
Nr. 68, datë 12.2.2014

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN, REFUZIMIN, RIPËRTËRITJEN DHE ANULIMIN E LEJES SË PUNËS, SI PUNËTOR SHTËPIAK, TË TIPIT “A/PSH”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, 86, pika 2, e 105, pika 1 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e tipit “A/PSH”, si punëtor shtëpiak, nëse plotëson kriteret, si më poshtë vijon:

a) ka një kontratë pune me një punëdhënës në përputhje me formimin e tij;

b) ka hyrë ose qëndron në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, që do të thotë me vizë, të llojeve të përcaktuara në nenet 21 e 22 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

2. Të huajt i ripërtërihet leja e punës e tipit “A/PSH”, si punëtor shtëpiak, nëse:

a) ka një kontratë pune të vlefshme në përputhje me punën e ushtruar prej tij, si punëtor shtëpiak, në rajonin gjeografik ku ka përfutur lejen e mëparshme të punës, por jo domosdoshmërisht me punëdhënësin që ka përfutur lejen e parë të tipit “A/PSH”;

b) është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) ka një vërtetim nga organet tatimore se ka shlyer të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

3. Kërkesa për pajisjen e të huajt me leje pune të tipit “A/PSH” bëhet nga:

a) i huaji;

b) punëdhënësi me të cilin i huaji ka një kontratë pune;

c) personi i autorizuar nga punëdhënësi.

4. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për pajisjen e të huajt, për herë të parë, me leje pune të tipit “A/PSH”, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajt me të dhënat personale, sipas formularit të dhënë në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) vendimin e gjykatës/ekstraktin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të personit fizik/juridik ose çdo personi tjetër, punëdhënës, ku ai do të punësohet;

c) kopjen origjinale të kontratës individuale të punës, e cila duhet të përmbajë, përveç elementeve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 21 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe kushtet e akomodimit dhe të ushqimit të punëtorit shtëpiak;

ç) vërtetimin nga punëdhënësit/organet tatimore për të ardhurat mujore të familjes së punëdhënësit të punëtorit shtëpiak, të cilat duhet të jenë pesë herë më shumë se paga me të cilën do të shpërblehet punëtori shtëpiak, sipas kontratës së punës;

d) kopjen e pasaportës së punëdhënësit;

dh) kopjen e pasaportës së punëmarrësit;

e) autorizimin nga punëdhënësi për personin e autorizuar;

ë) pesë fotografi;

f) dëshminë për formimin profesional të punëmarrësit, nëse ka të tillë për vendin e punës, sipas legjislacionit në vendin e origjinës ose të vendit ku ai është me qëndrim të ligjshëm.

5. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për pajisjen e të huajt me leje pune të ripërtëritur të tipit “A/PSH”, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajt me të dhënat personale;

b) kopjen e kontratës individuale të punës, e cila duhet të përmbajë, përveç elementeve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 21 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe kushtet e akomodimit e të ushqimit të punëtorit shtëpiak;

c) vërtetimin nga punëdhënësit/organet tatimore për të ardhurat mujore të familjes së punëdhënësit të punëtorit shtëpiak, të cilat duhet të jenë pesë herë më

shumë se paga me të cilën do të shpërblehet punëtori shtëpiak, sipas kontratës së punës;

c) autorizimin nga punëdhënësi për personin e autorizuar;

d) pesë fotografi;

dh) vërtetimin nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij vendimi, për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punëtorin shtëpiak.

6. Nëse punëtori shtëpiak, i cili kërkon të pajiset me leje pune të ripërtëritur të tipit “A/PSH”, ndryshon punëdhënësin, personat e përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, për ripërtëritjen e lejes së punës, paraqesin dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të tij.

7. Personat e përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të tij:

a) në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës ka vendbanimin punëdhënësi tek i cili do të punësohet, nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e tij të origjinës, ose pranë përfaqësisë diplomatike që mbulon vendin e tij të origjinës.

8. Zyra përkatëse e punësimit, kur kërkesa paraqitet pranë tyre, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 4 të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e tij brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

9. Zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës nga personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, verifikon:

a) shlyerjen e detyrimeve në organet tatimore, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit, si individ, kur nuk kryen aktivitet ekonomik;

b) shlyerjen e detyrimeve lidhur me pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit, pranë të cilit do të punësohet i huaji, kur kryen aktivitet ekonomik.

10. Zyra përkatëse e punësimit e pajis të huajin, për herë të parë, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, me leje pune njëvjeçare të tipit “A/PSH”, sipas formatit të dhënë në aneksin 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, nëse:

a) dokumentacioni i paraqitur është i plotë apo, pas plotësimit të tij nga personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, brenda afatit të përcaktuar, vlerësohet i rregullt;

b) përmbushen kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 9 të këtij vendimi;

c) i huaji paraqet, në çastin e marrjes së lejes së punës të tipit “A/PSH”, dokumentin e regjistrimit në organet tatimore, shoqëruar me NIPT-in e punëdhënësit.

11. Zyra përkatëse e punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi.

12. Zyra përkatëse e punësimit ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune të tipit “A/PSH” punëmarrësit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se:

a) nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 9 të këtij vendimi;

b) pozicioni i punës që i ofrohet, në rajonin gjeografik ku ndodhet punëdhënësi, mund të plotësohet nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2 të nenit 84 të ligjit nr. 108/2013;

c) është në kushtet e parashikuara në pikën 20 të këtij vendimi.

13. Nëse kërkesa është paraqitur pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit, ose pranë përfaqësisë diplomatike që mbulon vendin e origjinës së të huajit, kjo e fundit, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, ia përcjell dokumentacionin drejtorisë përgjegjëse për çështjet e migracionit në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

14. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet drejtorisë përgjegjëse për çështjet e migracionit, ia përcjell dokumentacionin e paraqitur zyrës përkatëse të punësimit, sipas kompetencës territoriale që ato kanë.

15. Zyra përkatëse e punësimit, për pajisjen/refuzimin e të huajit të lejes së punës të tipit “A/PSH”, ndjek procedurat e përcaktuara në pikat 8, 9, 10, 11 e 12 të këtij vendimi.

16. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, nëpërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, përcjell në Ministrinë e Punëve të Jashtme njoftimin për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit “A/PSH”.

17. Ministria e Punëve të Jashtme njofton përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit, për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit “A/PSH”.

18. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për ripërtëritjen e lejes së punës të tipit “A/PSH”, paraqesin brenda 30 (tridhjetë) ditëve para mbarimit të afatit të lejes ekzistuese kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5 ose 6 të këtij vendimi, në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, ka vendbanimin.

19. Zyra përkatëse e punësimit, për ripërtëritjen e lejes së punës të tipit “A/PSH” apo refuzimin e saj, brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, ndjek procedurat e parashikuara në pikat 8, 9, 10, 11 e 12 të këtij vendimi, ndërsa vlerësimi për kriteret dhe dokumentacionin do të bëhet sipas përcaktimeve në pikat 2, 5 ose 6, 9 dhe 20 të këtij vendimi. Afati i vlefshmërisë së lejes së ripërtërirë të punës, për punëtorët shtëpiakë, është njëvjeçar.

20. Të huajt i refuzohet lëshimi i lejes së punës të tipit “A/PSH” apo ripërtëritja e saj edhe nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në nenin 77 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

21. Të huajt i anulohet leja e punës e tipit “A/PSH”, nëse vërtetohet njëri nga rastet e përcaktuar në pikën 1 të nenit 80 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

22. I huaji, të cilit i refuzohet ose i anulohet leja e punës e tipit “A/PSH”, ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 81 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

23. Leja e punës e tipit “A/PSH” përfundon, nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 78 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

24. I huaji, i cili pajiset me leje pune të tipit “A/PSH”, për herë të parë, para marrjes së lejes së

punës detyrohet të paguajë tarifën prej 6 000 (gjashtë mijë) lekësh.

25. I huaji, të cilit i ripërtërihet leja e punës e tipit “A/PSH”, për herë të parë, para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 3 000 (tri mijë) lekësh.

26. Drejtoria përgjegjëse për çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga zyrat përkatëse të punësimit për dhënien e lejes së punës të tipit “A/PSH”.

27. Vendimi nr. 518, datë 6.7.2011 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen e anulimin e lejes së punës të tipit “C/PSH”, shfuqizohet.

28. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË



REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF SOCIAL
WELFARE AND YOUTH

DREJTORIA E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE MIGRATORE

EMPLOYMENT AND MIGRATION POLICIES DIRECTORATE
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT
NATIONAL EMPLOYMENT SERVICE

FORMULAR-KËRKESË / APPLICATION

për lëshimin e lejes së punës një të huaji / for issuance of work permit to a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT / INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit _____
Name of the employer

2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit _____
Seat and address of the employer

3. Numri i regjistrimit në ISSH |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Registration number in the Cr Health Insurance Institute

4. Kodi fiskal NIPT |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| OIB |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Business activity code

a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment or

b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit: _____
Abstract from National Registration Centre

5. Data e menduar e fillimit dhe e përfundimit të punës |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| deri në
|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|

Period for which the work permit is requested from to

6. Emërtimi i vendit të punës _____
Name of the job position

7. Kuotat vjetore **PO JO**
Yearly quota **YES NO**

8. Punësimi sezonal **PO JO**
Seasonal employment **YES NO**

9. Migrimi ditor **PO JO**
Daily migration **YES NO**

2. TË DHËNAT E TË HUAJIT / INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mbiemri _____
Surname

2. Emri _____
Given name(s)

3. Emri i babait _____
Name of the parent

4. Datëlindja |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Date of birth

5. Gjinia **F M** |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Sex **M F*** to be entered if issued

6. Vendi dhe shteti i lindjes _____
Place and country of birth

7. Shtetësia _____
Nationality

8. Adresa e banimit në Shqipëri _____
Residential address in the Republic of Albania

9. Kodi dhe emri i punësimit |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| _____
Code and name of occupation

10. Kualifikimet |__|__|__|__|_____
Skill qualifications

11. Aktivitet fitimprurës **PO JO**
Gainfully employed **YES NO**

3. DOKUMENTI I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit _____
Type of document

2. Numri |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|_____
Number

3. Lëshuar në |__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Issued on

4. E vlefshme deri më |__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Valid until

5. Autoriteti kompetent _____
Competent authority

6. Lëshuar nga _____
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
(Applicant)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT

ANEKSI 2

Nr. ____ prot.

Datë

LEJE PUNE PËR TË HUAJ

TIPI:

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr., datë __.__.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me leje pune”,

Z./znj. _____
Mr/Ms (emri, mbiemri / Given name(s) Surname)

FOTOGRAFIA / PHOTO

Lindur më _____
Born on (data, muaji, viti / Day Month Year)

Në _____
In (vendlindja / Place and country of birth)

Gjendja civile _____
(Civil Status)

Me shtetësi _____
Nationality

Me profesion _____
Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____
Type of document and number

I huaji pajiset me leje pune të tipit _____, pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në nenin të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj:
Name of the employer

Statusi i subjektit: _____
(Subject's Legal Status)

Spektori i aktivitetit: _____
(Sector of Activity)

Me adresë: _____
Seat and address

Vlefshmëria e lejes: _____
(Work Permit Validity)

Data e lëshimit: _____
(Issuance Date)

Data e skadimit: _____
(Expiration Date)

Pagesa: _____
(Application Fee)

Kjo leje pune është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në këtë kategori punësimi, bazuar në ligjin nr. 108/2013, datë 28.3.2013 "Për të huajt".

Institucioni lëshues: _____
(Issuing Authority)

DREJTOR

VENDIM

Nr. 69, datë 12.2.2014

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN, REFUZIMIN DHE ANULIMIN E LEJES SË PËRHERSHME TË PUNËS, TË TIPIT "D"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, 86, pika 2, e 105, pika 1 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e përhershme, e tipit "D", pasi të ketë marrë lejen e dytë, me afat dyvjeçar, nëse plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 103 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", si më poshtë vijon:

a) ka qëndruar dhe është punësuar ligjërisht dhe pa ndërprerje për 5 (pesë) vjet, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) ka leje pune paraardhëse njëvjeçare, si dhe dy leje pune dyvjeçare, të njëpasnjëshme;

c) lejet e mëparshme nuk janë të tipave të përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 4 të nenit nr. 103 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt";

ç) ka të ardhura vetjake, të qëndrueshme dhe të mjaftueshme, për vete dhe për anëtarët e familjes në ngarkim, në shumën e pagës minimale vjetore të shtetasit shqiptar;

d) ka derdhur sigurime të plota shoqërore dhe shëndetësore për vete dhe për anëtarët e familjes në ngarkim;

dh) ka strehim të përshtatshëm për vete dhe anëtarët e familjes në ngarkim;

e) ka njohuri të mira të gjuhës e të kulturës shqiptare.

2. Kërkesa për t'u pajisur me leje pune të tipit "D" bëhet nga:

a) i huaji;

b) punëdhënësi, me të cilin i huaji ka një kontratë pune;

c) personi i autorizuar nga punëdhënësi.

3. Personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajit me të dhënat personale, sipas formatit të dhënë në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) kopjen e kontratës individuale të punës;

c) kopjet e lejeve të punës paraardhëse;

ç) kopjen e lejes së qëndrimit;

d) vërtetimin e gjendjes së llogarisë bankare;

dh) vërtetimin për derdhjen e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vete dhe për anëtarët e familjes në ngarkim;

e) kontratën e pronësisë ose të marrjes me qira të mjediseve të banimit;

ë) pesë fotografi.

4. Personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, për t'u pajisur me leje pune të tipit "D", paraqesin dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 3 të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

6. Nëse Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit vlerëson se dokumentacioni i paraqitur është i plotë apo pas plotësimit brenda afatit të caktuar, përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, e pajis të huajin, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune me leje pune, të tipit "D", sipas formatit të dhënë në aneksin 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune të tipit "D" të huajit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, ose është në kushtet e pikës 10 të këtij vendimi.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për pajisjen me leje pune të vazhdueshme të tipit "D", për personat e parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", ndjek procedurat e parashikuara në pikat 5, 6, 7 e 8 të këtij vendimi, ndërsa për kriteret dhe dokumentacionin, vlerësimi bëhet sipas përcaktimeve në pikat 1 e 3 të këtij vendimi.

10. Anulimi dhe refuzimi i lejes së punës të tipit "D" bëhet kur i huaji është në njërën nga situatat e parashikuara përkatësisht në nenet 80, pika 1 dhe 77 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

11. I huaji, të cilit i refuzohet ose i anulohet leja e punës e tipit "D", ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 81 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

12. Leja e punës e tipit "D" përfundon nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenet 7 e 8 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

13. I huaji, i cili pajiset me leje pune të tipit "D", para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 10000 (dhjetë mijë) lekësh.

14. Drejtoria, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit për dhënien e lejes së punës.

15. Vendimi nr. 356, datë 6.3.2009 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes për punë të vazhdueshme", shfuqizohet.

16. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË



REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF SOCIAL
WELFARE AND YOUTH

DREJTORIA E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE MIGRATORE

EMPLOYMENT AND MIGRATION POLICIES DIRECTORATE
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT
NATIONAL EMPLOYMENT SERVICE

FORMULAR-KËRKESË / APPLICATION

për lëshimin e lejes së punës një të huaji / for issuance of work permit to a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT / INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit _____
Name of the employer
2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit _____
Seat and address of the employer
3. Numri i regjistrimit në ISSH |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Registration number in the Cr Health Insurance Institute
4. Kodi fiskal NIPT |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| **OIB** |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Business activity code
 - a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment or
 - b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit: _____
Abstract from National Registration Centre
5. Data e menduar e fillimit dhe e përfundimit të punës |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| deri në
|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Period for which the work permit is requested from to
6. Emërtimi i vendit të punës _____
Name of the job position
7. Kuotat vjetore **PO JO**
Yearly quota **YES NO**
8. Punësimi sezonal **PO JO**
Seasonal employment **YES NO**
9. Migrimi ditor **PO JO**
Daily migration **YES NO**

2. TË DHËNAT E TË HUAJIT / INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mbiemri _____
Surname
2. Emri _____
Given name(s)
3. Emri i babait _____
Name of the parent
4. Datëlindja |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Date of birth
5. Gjinia **F M** |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|

Sex *M F* * to be entered if issued

6. Vendi dhe shteti i lindjes _____
Place and country of birth

7. Shtetësia _____
Nationality

8. Adresa e banimit në Shqipëri _____
Residential address in the Republic of Albania

9. Kodi dhe emri i punësimit |__|__|__|__|__|__|_____
Code and name of occupation

10. Kualifikimet |__|__|__|_____
Skill qualifications

11. Aktivitet fitimprurës *PO JO*
Gainfully employed *YES NO*

3. DOKUMENTI I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit _____
Type of document

2. Numri |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|_____
Number

3. Lëshuar në |__|__|__|__|__|__|_____
Issued on

4. E vlefshme deri më |__|__|__|__|__|__|_____
Valid until

5. Autoriteti kompetent _____
Competent authority

6. Lëshuar nga _____
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
(Applicant)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT

Nr. _____ prot.

Datë

LEJE PUNE PËR TË HUAJ

TIPI:

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr., datë __.__.2013 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me leje pune”,

Z./znj. _____
Mr/Ms (emri, mbiemri / Given name(s) Surname)

FOTOGRAFIA / PHOTO

Lindur më _____
Born on (data, muaji, viti / Day Month Year)

Në _____
In (vendlindja / Place and country of birth)

Gjendja civile _____
(Civil Status)

Me shtetësi _____
Nationality

Me profesion _____
Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|
Type of document and number

I huaji pajiset me leje pune të tipit _____, pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në nenin të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj:
Name of the employer

Statusi i subjektit: _____
(Subject's Legal Status)

Spektori i aktivitetit: _____
(Sector of Activity)

Me adresë: _____
Seat and address

Vlefshmëria e lejes: _____
(Work Permit Validity)

Data e lëshimit: _____
(Issuance Date)

Data e skadimit: _____
(Expiration Date)

Pagesa: _____
(Application Fee)

Kjo leje pune është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në këtë kategori punësimi, bazuar në ligjin nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Institucioni lëshues: _____
(Issuing Authority)

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

VENDIM Nr. 70, datë 12.2.2014

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË REGJISTRIMI NË PUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, e 73, pika 4 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. I huaji pajiset me certifikatë regjistrimi në punë, nëse plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

2. Kërkesa për pajisje me certifikatë regjistrimi në punë bëhet nga:

- a) i huaji;
- b) punëdhënësi, me të cilin i huaji ka një kontratë pune;
- c) personi i autorizuar nga punëdhënësi.

3. Personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, për t’u pajisur me certifikatë regjistrimi në punë, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën për pajisje me certifikatë regjistrimi në punë, sipas formatit të dhënë në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
- c) një kontratë pune ose vërtetim nga punëdhënësi, i huaj ose shqiptar;
- ç) pesë fotografi;

d) për kategoritë e përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 2 dhe shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 73 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i huaji duhet të paraqesë një kopje të marrëveshjes dypalëshe qeveritare ose të marrëveshjes ndërmjet institucioneve arsimore.

4. Personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, paraqesin kërkesën për t’u pajisur me certifikatë regjistrimi në punë dhe dokumentacionin e parashikuar në pikën 3 të tij:

a) pranë drejtorisë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, kur i huaji është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e tij të origjinës ose në përfaqësinë diplomatike që mbulon vendin e tij të origjinës.

5. Nëse kërkesa paraqitet në drejtorinë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ajo, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 2 të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

6. Drejtorja që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nëse vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, është i plotë apo, pas plotësimit të tij brenda afatit të përcaktuar, i përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 108/2013, e pajis të huajin me certifikatën e regjistrimit në punë, sipas formatit të dhënë në aneksin 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

7. Drejtorja që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur personit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të tij.

8. Drejtorja që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, refuzon kërkesën për pajisjen me certifikatë regjistrimi në punë të personit, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

9. Nëse kërkesa është paraqitur pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit ose pranë përfaqësisë diplomatike që mbulon vendin e tij të origjinës, kjo e fundit,

nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, e përcjell dokumentacionin e paraqitur pranë saj në drejtorinë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

10. Drejtoria që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për pranimin/refuzimin e të huajt për pajisje me certifikatë regjistrimi në punë, ndjek procedurat e përcaktuara në pikat 5, 6, 7 e 8 të këtij vendimi.

11. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë përcjell në Ministrinë e Punëve të Jashtme njoftimin për pranimin/refuzimin e kërkesës së të huajt për t'u pajisur me certifikatë regjistrimi në punë.

12. Ministria e Punëve të Jashtme njofton përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajt, për pranimin/refuzimin e kërkesës së të huajt, për pajisje me certifikatë regjistrimi në punë.

13. Të huajt i refuzohet pajisja me certifikatë regjistrimi në punë edhe nëse vërtetohet njëri nga rastet e përcaktuara në nenin 77 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

14. Të huajt i anulohet pajisja me certifikatë regjistrimi në punë, nëse vërtetohet njëri nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 80 të ligjit nr. 108/2013

"Për të huajt".

15. I huaji, të cilit i refuzohet ose i anulohet pajisja me certifikatë regjistrimi në punë, ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 81 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

16. Drejtoria që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, bën regjistrimin e të huajve, shtetas të BE-së, që plotësojnë kushtet e punësimit për përjashtim nga detyrimi i pajisjes me leje pune, sipas neneve 72, shkronja "a" dhe 73, pikat 1, 2 e 3 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

17. Vendimi nr. 360, datë 6.3.2009 i Këshillit të Ministrave "Për dokumentacionin dhe procedurën për përjashtimin nga detyrimi për pajisjen me leje pune", shfuqizohet.

18. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË



REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF SOCIAL
WELFARE AND YOUTH

DREJTORIA E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE MIGRATORE

EMPLOYMENT AND MIGRATION POLICIES DIRECTORATE
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT
NATIONAL EMPLOYMENT SERVICE

FORMULAR-KËRKESË / APPLICATION

për lëshimin e lejes së punës një të huaji / for issuance of work permit to a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT / INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit _____
Name of the employer

2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit _____
Seat and address of the employer

3. Numri i regjistrimit në ISSH |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Registration number in the Cr Health Insurance Institute

4. Kodi fiskal NIPT |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| OIB |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Business activity code

a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment or

3. Lëshuar në |__|__|__|__|__|__|__|__|__|
 Issued on

4. E vlefshme deri më |__|__|__|__|__|__|__|__|__|
 Valid until

5. Autoriteti kompetent _____
 Competent authority

6. Lëshuar nga _____
 Place and country of issuance

Vendi dhe data
 (Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
 (Applicant)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E MIRËQENIES
 SOCIALE DHE RINISË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . ____

Certifikatë regjistrimi

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”, nenit 73 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr., datë __. __. 2013 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me certifikatë regjistrimi në punë”.

Pajisjet me certifikatë regjistrimi në punë:

Z. _____
 Sr _____
 (emri, mbiemri / Given name(s) Surname)

FOTOGRAFIA / PHOTO

Lindur më _____
 Born on _____
 (data, muaji, viti / Day Month Year)

Në _____
 In _____
 (vendlindja / Place and country of birth)

Me shtetësi _____
 Nationality

Me profesion _____
 Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____
 Type of document and number

Lëshuar në datën _____
 Issued on (data, muaji, viti / Day Month Year)

E cila skadon më _____
 Valid until (data, muaji, viti / Day Month Year)

I huaji pajiset me “Certifikatë regjistrimi në punë” pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në germen “__” të pikës ____ të nenit 73 të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Me adresë: _____
 Seat and address

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj: “ _____ ”
 Name of the employer

Me adresë: _____
 Seat and address

Kjo certifikatë është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në një nga kategoritë e subjekteve të përcaktuara në pikat 1, 2, 3 të nenit 73 të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

DREJTOR

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 72, datë 12.2.2014

**PËR IDENTIFIKIMIN E SIPËRFAQES SË
TOKËS PREJ 25 000 HA, NË PRONËSI
SHTETËRORE, DHËNË NË PËRDORIM
NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE, E CILA
DO TË KALOJË NË FONDIN E KOMPENSIMIT
FIZIK, NË DISPOZICION TË AGJENCISË SË
KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të shkronjës “b” të nenit 14 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, të ministrit të Drejtësisë e të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, do të kalojë një sipërfaqe toke prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim njësive të qeverisjes vendore.

2. Ngarkohen Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronës, drejtoritë e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, pranë këshillave të qarqeve, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të identifikojnë dhe të vlerësojnë sipërfaqen e tokës, e cila do të kalojë në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

3. Lista për sipërfaqen e tokës në përdorim të njësive të qeverisjes vendore, që do të kalojë në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duhet t'i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave pas përfundimit të saj.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

VENDIM
Nr. 73, datë 12.2.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË
VENDIMIN NR. 1114, DATË 30.7.2008
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA
ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR. 7703,
DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, NR. 9136,
DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E
KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE E
SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE NR.
7870, DATË 13.10.1993 “PËR SIGURIMET
SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

1. Në titull dhe kudo në përmbajtjen e tij, fjalët “... të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1993 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ...” zëvendësohen me “... të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ...” dhe emërtimi “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohet me “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë”.

2. Në shkronjat “f” dhe “g” të pikës 1 të kreut I “Mbrojtja dhe siguri i detyrueshëm”, pas fjalëve “... vetëm për degën e pensioneve ...” shtohen “... dhe për siguri shëndetësor ...”.

3. Pika 2 e kreut II “Paga bruto dhe paga minimale”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, nga data 1.1.2014 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 19026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekë. Paga maksimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore, nga data 1.1.2014 e në vazhdim, të jetë 95130 (nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë. Paga maksimale, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shëndetësore, nga data 1.1.2014, të jetë paga bruto, sipas përcaktimeve në pikën 1 të kreut II “Paga bruto dhe paga minimale”.

Për të punësuarit, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, paga minimale mujore për llogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është ajo e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit 111 të ligjit të sipërpërmendur, e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale, e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike.”.

4. Në paragrafin e parë të kreut III “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve”, fjalët “... dhe të neneve 8, 9, 10, 11 e 12 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ...” zëvendësohen me “... dhe të neneve 5, 6, 7, 8 dhe 9 të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ...”.

5. Pikat 2, 6, 7, 9, 10, 12 e 13 të kreut III “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve”, ndryshohen si më poshtë vijon:

“2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarit dhe për pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë (me përjashtim të të vetëpunësuarve në bujqësi), nga data 1.1.2014 e në vazhdim, të jetë 3.4 % e dyfishit të pagës minimale mujore, të përcaktuar në pikën 2 të kreut II “Paga bruto dhe paga minimale”, e barabartë me 1294 (një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

...

6. I vetëpunësuarit, i vetëpunësuarit në ortakëri, i vetëpunësuarit, që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.1.2014 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm, për sigurimet shoqërore, në masën 23% të pagës mujore minimale, prej 19026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh, e barabartë me 4376 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

I vetëpunësuarit, i vetëpunësuarit në ortakëri, i vetëpunësuarit, që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.1.2014 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shëndetësore, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore të përcaktuar në pikën 2 të kreut II “Paga bruto dhe paga minimale”, të barabartë me 1294 (një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë në muaj.

7. I vetëpunësuarit, për pjesëtarët e familjes së tij, mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërishit (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.1.2014 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore, në masën 23 përqind të pagës mujore minimale prej 19026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh, të barabartë me 4376 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

I vetëpunësuarit, për pjesëtarët e familjes së tij, mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërishit (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.1.2014 e në vazhdim, paguan një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shëndetësore, në masën 3.4 përqind të dyfishit të pagës minimale mujore të përcaktuar në pikën 2 të kreut II “Paga bruto dhe paga minimale”, të barabartë me 1294 (një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë në muaj.

...

9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbim ambulant, nga data 1.1.2014 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 3794 (tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, nga të cilat 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë për sigurime shoqërore dhe 1294 (një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë për sigurime shëndetësore.

10. Personat mbi moshën 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga data 1.1.2014 e në vazhdim, paguajnë kontribute vetëm për sigurimin shëndetësor, në masën 3.4 % të dyfishit të pagës minimale mujore të përcaktuar në pikën 2 të kreut II “Paga bruto dhe paga minimale”, të barabartë me 1294 (një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë në muaj.

...

12. Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore për të vetëpunësuarit në bujqësi, është 4200 (katër mijë e dyqind) lekë.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.1.2014 e në vazhdim, derdhin kontribut mujor për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, në masën 3.4 % të dyfishit të pagës minimale mujore për efekt të kontributeve të

sigurimeve shëndetësore të të vetëpunësuarve në bujqësi, të barabartë me një vlerë prej 286 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh në muajt.

13. Për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, nga data 1.1.2014 e në vazhdim, deklarohet dhe paguhet kontribut mujor në shumën 3794 (tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, nga të cilat 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë kontribut i detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe 1294 (një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë kontribut i detyrueshëm për sigurimet shëndetësore.”.

6. Në fjalinë e parë të pikës 10 të kreut V “Pagesa e kontributeve”, pas fjalëve “... sigurimeve shoqërore ...” shtohen “... dhe shëndetësore ...”.

VENDIM

Nr. 74, datë 12.2.2014

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN, REFUZIMIN DHE ANULIMIN E LEJES SË PUNËS, PËR SHËRBIME VULLNETARE, TË TIPIT “A/SHV”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, e 86, pika 2, të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e tipit “A/SHV”, si person që kryen shërbime vullnetare në kuadër të shkëmbimeve rinore ose si person i punësuar sipas skemave të shërbimeve vullnetare, nëse plotëson kriteret mëposhtme:

a) ka një marrëveshje në organizatën jofitimprurëse, që ofron shërbime vullnetare bamirësie në territorin e Republikës së Shqipërisë për shërbimin vullnetar që do të ofrohet dhe për përgjegjësitë e kësaj organizate për këtë të huaj për sigurimin e jetës, sigurimet shëndetësore dhe shpenzimet e udhëtimit;

b) shërbimi është tërësisht vullnetar për të huajt që do të ofrojnë shërbime vullnetare;

c) ka një marrëveshje ndërshtetërore me shtetin e origjinës së të huajt, si persona të punësuar në kuadër të shkëmbimeve rinore apo skemave të shërbimeve vullnetare, ku të jenë përcaktuar përgjegjësitë e palëve për këtë të huaj për sigurimin e jetës, sigurimet shëndetësore dhe shpenzimet e udhëtimit;

ç) ka një kontratë pune, si i punësuar, për të huajt që vijnë në kuadër të shkëmbimeve rinore apo skemave të shërbimeve vullnetare;

d) kohëzgjatja e përgjithshme e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të mos jetë më shumë se një vit;

dh) organizata jofitimprurëse, që ofron shërbime

7. Në kreun VI “Procedurat e kalimit të kontributit dhe mbledhja e borxheve”, bëhen këto shtesa:

a) Në fjalinë e parë të pikës 2, pas fjalëve “... Instituti i Sigurimeve Shoqërore ...” shtohen “... dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ...”.

b) Në fund të pikës 3 shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

“Kontributet e sigurimeve shëndetësore vullnetare derdhen në llogaritë bankare të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2014.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

vullnetare bamirësie në territorin e Republikës së Shqipërisë, punëdhënësi për të punësuarit në kuadër të shkëmbimeve rinore apo skemave të shërbimeve vullnetare, nuk kanë kryer shkëlqje të legjislacionit të punës në vitin kalendarik paraardhës;

e) organizata jofitimprurëse, që ofron shërbime vullnetare bamirësie në territorin e Republikës së Shqipërisë, a punëdhënësi për të punësuarit në kuadër të shkëmbimeve rinore kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për vitin kalendarik paraardhës;

ë) organizata jofitimprurëse, që ofron shërbime vullnetare bamirësie në territorin e Republikës së Shqipërisë, ka burime të mjaftueshme për financimin e shërbimit vullnetar;

f) ka hyrë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për t’u pajisur me leje pune të tipit “A/SHV” bëhet nga:

a) i huaji;

b) punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet në kuadër të shkëmbimeve rinore;

c) organizata jofitimprurëse, që ofron shërbime vullnetare bamirësie në territorin e Republikës së Shqipërisë për të huajt, që do të jenë në shërbim vullnetar;

ç) personi i autorizuar nga punëdhënësi/organizata jofitimprurëse, që ofron shërbime vullnetare bamirësie në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, për t’u pajisur me leje pune të tipit “A/SHV”, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me të dhënat personale, sipas formatit të dhënë në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) kopjen e përkthyer e të noterizuar të marrëveshjes me organizatën jofitimprurëse, që ofron shërbime bamirësie në territorin e Republikës së Shqipërisë për të huajt, që do të shërbejnë vullnetarisht;

c) kopjen e përkthyer e të noterizuar të marrëveshjes ndërshtetërore me shtetin e origjinës së të huajit, për të punësuarit në kuadër të shkëmbimeve rinore;

c) deklaratën se shërbimi vullnetar, që do të ofrojë, do të jetë pa shpërblim;

d) kopjen e kontratës individuale të punës për të punësuarit në kuadër të shkëmbimeve rinore;

dh) dokumentin bankar për burimin e financimit të shërbimit vullnetar të bamirësisë, që ofron organizata jofitimprurëse;

e) kopjen e përkthyer e të noterizuar të policës së sigurimit të jetës;

ë) kopjen e pasaportës;

f) autorizimin nga punëdhënësi/organizata jofitimprurëse për personin e autorizuar;

g) pesë fotografi.

4. Personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi:

a) në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës organizata jofitimprurëse ushtron veprimtarinë dhe nëse i huaji, që do të marrë pjesë në shërbimin vullnetar, është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse organizata jofitimprurëse e ushtron veprimtarinë në më shumë se një rajon gjeografik dhe nëse i huaji, që do të marrë pjesë në shërbimin vullnetar, është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e tij të origjinës ose në përfaqësinë diplomatike që mbulon vendin e tij të origjinës për të huajin, i cili është në vendin e origjinës dhe do të vijë për shërbim vullnetar apo në kuadër të shkëmbimeve rinore.

5. Nëse kërkesa paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrës përkatëse të punësimit, autoriteti përkatës, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 3 të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e këtij dokumentacioni, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës nga personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, verifikon shlyerjen e detyrimeve lidhur me pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit, pranë të cilit do të punësohet i huaji.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, nëse vlerëson se dokumentacioni i paraqitur është i plotë apo pas

plotësimin të tij brenda afatit të përcaktuar është i rregullt, vlerëson nëse i huaji i përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 6 të këtij vendimi, dhe e pajis atë brenda 10 (dhjetë) ditëve pune me leje pune të tipit "A/SHV", sipas formatit të dhënë në aneksin 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune të tipit "A/SHV" punëmarrësit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 6 të këtij vendimi, ose është në kushtet e përcaktuara në pikën 15 të këtij vendimi.

10. Nëse kërkesa është paraqitur pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit, ajo, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, ia përcjell dokumentacionin e paraqitur drejtorisë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

11. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet drejtorisë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, ia përcjell dokumentacionin e paraqitur Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrës përkatëse të punësimit, sipas kompetencës territoriale, që ato kanë.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, për pajisjen/refuzimin e të huajit me leje pune të tipit "A/SHV", ndjekin procedurat e përcaktuara në pikat 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij vendimi.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, nëpërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e përcjell në Ministrinë e Punëve të Jashtme njoftimin për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit "A/SHV".

14. Ministria e Punëve të Jashtme njofton përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit, për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit "A/SHV".

15. Të huajit i refuzohet lëshimi i lejes së punës e tipit "A/SHV" edhe nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në nenin 77 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

16. Të huajit i anulohet leja e punës e tipit "A/SHV" nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 80 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

17. I huajit, të cilit i refuzohet ose i anulohet leja e punës e tipit "A/SHV", ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 81 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

18. Leja e punës e tipit “A/SHV” përfundon nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 78 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

19. Drejtorja, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për dhënien e lejes së punës.

20. Vendimi nr. 350, datë 6.3.2009 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të

dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës të tipit A/SHV”, shfuqizohet.

21. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË**



**REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF SOCIAL
WELFARE AND YOUTH**

DREJTORIA E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE MIGRATORE

**EMPLOYMENT AND MIGRATION POLICIES DIRECTORATE
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT
NATIONAL EMPLOYMENT SERVICE**

FORMULAR-KËRKESË / APPLICATION

për lëshimin e lejes së punës një të huaji / for issuance of work permit to a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT / INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit _____
Name of the employer
2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit _____
Seat and address of the employer
3. Numri i regjistrimit në ISSH |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Registration number in the Cr Health Insurance Institute
4. Kodi fiskal NIPT |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Business activity code
a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment or
b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit: _____
Abstract from National Registration Centre
5. Data e menduar e fillimit dhe e përfundimit të punës |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|_____|
Period for which the work permit is requested from to
6. Emërtimi i vendit të punës _____
Name of the job position
7. Kuotat vjetore **PO JO**
Yearly quota **YES NO**
8. Punësimi sezonal **PO JO**
Seasonal employment **YES NO**

9. Migrimi ditor **PO JO**
Daily migration **YES NO**

2. TË DHËNAT E TË HUAJIT / INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mbiemri _____
Surname
2. Emri _____
Given name(s)
3. Emri i babait _____
Name of the parent
4. Datëlindja |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Date of birth
5. Gjinia **F M** |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Sex **M F*** to be entered if issued
6. Vendi dhe shteti i lindjes _____
Place and country of birth
7. Shtetësia _____
Nationality
8. Adresa e banimit në Shqipëri _____
Residential address in the Republic of Albania
9. Kodi dhe emri i punësimit |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__| _____
Code and name of occupation
10. Kualifikimet |__|__|__|
Skill qualifications
11. Aktivitet fitimprurës **PO JO**
Gainfully employed **YES NO**

3. DOKUMENTI I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit _____
Type of document
2. Numri |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Number
3. Lëshuar në |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Issued on
4. E vlefshme deri më |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Valid until
5. Autoriteti kompetent _____
Competent authority
6. Lëshuar nga _____
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
(Applicant)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT

ANEKSI 2

Nr. _____ prot.

Datë.....

LEJE PUNE PËR TË HUAJ
TIPI:

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr., datë __. __.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me leje pune”,

Z./znj. _____
Mr/Ms (emri, mbiemri / Given name(s) surname)

FOTOGRAFIA / PHOTO

Lindur më _____
Born on (data, muaji, viti / Day Month Year)

Në _____
In (vendlindja / Place and country of birth)

Gjendja civile _____
(Civil Status)

Me shtetësi _____
Nationality

Me profesion _____
Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ |
Type of document and number

I huaji pajiset me leje pune të tipit _____, pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në nenin të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj:
Name of the employer

Statusi i subjektit: _____
(Subject’s Legal Status)

Spektori i aktivitetit: _____
(Sector of Activity)

Me adresë: _____
Seat and address

Vlefshmëria e lejes: _____
(Work Permit Validity)

Data e lëshimit: _____
(Issuance Date)

Data e skadimit:
(Expiration Date) _____

Pagesa:
(Application Fee) _____

Kjo leje pune është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në këtë kategori punësimi, bazuar në ligjin nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Institucioni lëshues:
(Issuing Authority) _____

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

VENDIM Nr. 75, datë 12.2.2014

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN, REFUZIMIN DHE ANULIMIN E LEJES SË PUNËS, SI PUNËTOR STINOR, TË TIPIT “A/PS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, 86, pika 2, e 105, pika 1 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajit i jepet leje pune e tipit “A/PS”, si punëtor stinor, nëse plotëson kriteret, si më poshtë vijon:

a) ka një marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendit të tij të origjinës;

b) nuk është me banim të vazhdueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) ka një kontratë pune me afat deri në gjashtë muaj, për atë vit kalendarik, me një punëdhënës, në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendit të tij të origjinës;

ç) ka një ndërprerje kohore prej gjashtë muajsh nga punësimi i fundit stinor, në vitin pasardhës kalendarik;

d) është rikthyer në vendin e tij të origjinës, pas punësimit të fundit stinor, në vitin paraardhës kalendarik.

2. Kërkesa për t'u pajisur me leje pune të tipit “A/PS” bëhet nga:

a) i huaji;

b) punëdhënësi, me të cilin i huaji ka një kontratë pune;

c) personi i autorizuar nga punëdhënësi.

3. Personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën, me të dhënat personale, sipas formatit të dhënë në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) kopjen e kontratës individuale të punës;

c) kopjen e pasaportës;

ç) autorizimin nga punëdhënësi, për personin e autorizuar;

d) pesë fotografi.

4. Personat e përmendur në pikën 2 paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin e tij të origjinës ose në përfaqësinë diplomatike që mbulon vendin e tij të origjinës.

5. Përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë në vendin e origjinës së të huajit, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme (Qendrës Kombëtare të Vizave), e përcjell dokumentacionin e paraqitur pranë saj në drejtorinë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

6. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet drejtorisë që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, e përcjell dokumentacionin e paraqitur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrën përkatëse të punësimit, sipas kompetencës territoriale që ato kanë.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pasi shqyrton dokumentacionin dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 3 të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e këtij dokumentacioni brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pasi merr dokumentacionin e plotë apo pas plotësimit të tij brenda afatit të përcaktuar, vlerëson nëse ai i përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, dhe e pajis të huajin, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, me leje pune të tipit “A/PS”, sipas formatit të dhënë në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia refuzon të huajit pajisjen me leje pune të tipit “A/PS”, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të

3. DOKUMENTI I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit _____
Type of document
2. Numri |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Number
3. Lëshuar në |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Issued on
4. E vlefshme deri më |__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Valid until
5. Autoriteti kompetent _____
Competent authority
6. Lëshuar nga _____
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
(Applicant)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT

ANEKSI 2

Nr. ____ prot.

Datë

LEJE PUNE PËR TË HUAJ

TIPI:

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr., datë __. __. 2013 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me leje pune”,

Z./znj. _____

Mr/Ms (emri, mbiemri / Given name(s) surname)

Lindur më _____

Born on (data, muaji, viti / Day Month Year)

Në _____

In (vendlindja/ Place and country of birth)

Gjendja civile _____

(Civil Status)

Me shtetësi _____


Nationality

Me profesion _____

Skill qualifications

478

FOTOGRAFIA / PHOTO



Lloji i dokumentit dhe numri _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____
 Type of document and number

I huaji pajiset me leje pune të tipit _____, pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në nenin të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj:

Name of the employer

Statusi i subjektit: _____
 (Subject's Legal Status)

Sektori i aktivitetit: _____
 (Sector of Activity)

Me adresë: _____
 Seat and address

Vlefshmëria e lejes: _____
 (Work Permit Validity)

Data e lëshimit: _____
 (Issuance Date)

Data e skadimit: _____
 (Expiration Date)

Pagesa: _____
 (Application Fee)

Kjo leje pune është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në këtë kategori punësimi, bazuar në ligjin nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”.

Institucioni lëshues: _____
 (Issuing Authority)

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

konstatoi se:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezulton se janë plotësuar sipas kërkesave ligjore, pikat si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2

Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit.

- Neni 7, pika 1.3/“a”, “b”

Përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij.

- Neni 7, pika 1.3/“c”

Gjendja financiare në kohën kur paraqitet kërkesa dhe efekti i pritshëm pas transferimit të aseteve.

Janë plotësuar, gjithashtu, pika 1.3/“d”, “e”, “f”, “g”, “h” të nenit 7 të rregullores:

- Pika 1.3/“d” - Përshkrimin e kandidatit përfitues.

- Pika 1.3/“e” - Arsyet dhe shkaku ligjor i barrësimit - motivet.

- Pika 1.3/“f” - Efektet e pritshme të transferimit (dhënies peng/hipotekë) në aktivitetin e të licencuarit.

- Pika 1.3/“g” - Efekti në furnizimin e rregullt e të

VENDIM

Nr. 6, datë 30.1.2014

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË HEC “ULËZ”- “SHKOPET”, “BISTRICA 1” DHE “BISTRICA 2” NË KUADËR TË MARRËVESHJES ME “IFC”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 8 të “Rregullores së procedurave e të transferimit të aseteve të të licencuarve”, si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e datës 30.1.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

qëndrueshëm të klientëve të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar.

- Pika 1.3/“h” - Marrëveshja paraprake.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., për transferimin e asetëve të HEC “Ulëz”-“Shkopet”, “Bistrica 1” dhe “Bistrica 2” në kuadër të marrëveshjes me “IFC”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë “Kurum International” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 7, datë 6.2.2014

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
KURUM INTERNATIONAL SHA, PËR
TRANSFERIMIN E ASETËVE TË HEC “ULËZ”-
“SHKOPET”, “BISTRICA 1” DHE “BISTRICA 2”
NË KUADËR TË MARRËVESHJES ME “IFC”,
“BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA”,
“BLACK SEA TRADE AND DEVELOPMENT
BANK” AND “RAIFFEISEN BANK SHA”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 të “Rregullores të procedurave e të transferimit të asetëve të të licencuarve”, si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 6.2.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti rezulton se janë plotësuar sipas kërkesave ligjore pikat si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2

Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit:

- Neni 7, pika 1.3/ “a”, “b”

Përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij.

Neni 7, pika 1.3 “c”

“Gjendja financiare në kohën kur paraqitet kërkesa dhe efekti i pritshëm pas transferimit të asetëve.

Janë plotësuar gjithashtu pika 1.3/ “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, të nenit 7 të Rregullores:

- Pika 1.3/ “d” – Përshkrimin e kandidatit përfitues.

- Pika 1.3/ “e”-Arsyet dhe shkakut ligjor i barrësimit-motivet.

- Pika 1/3/ “f”-Efektet e pritshme të transferimit (dhënies peng/hipotekë) në aktivitetin e të licencuarit.

- Pika 1.3 “g” – Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar.

- Pika 1.3 “h” - Marrëveshjet paraprake.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën nr. 87, prot, datë 20.1.2014, të shoqërisë “Kurum International sh.a.” për transferimin e asetëve të HEC “Ulëz”-“Shkopet”, “Bistrica 1” dhe “Bistrica 2” dhe miratimet e kërkuara në të, në kuadër të:

- Marrëveshjes së kushteve paraprake të datës 19.12.2013, lidhur me paketën siguruese të financimit, me përfitues kolateral “Raiffeisen Bank sh.a.” në rolin e agentit të kolateralit të huadhënësve kryesorë (“IFC”, “Banka Kombëtare Tregtare sh.a.”, “Black Sea Trade and Development Bank” and “Raiffeisen Bank sh.a.”), të rënë dakord nga palët në këtë dokument (në definicionin “Dokumentet e sigurisë”);

- Marrëveshjes së barrës siguruese mbi të gjitha asetet e luajtshme të prekshme, aktuale dhe të ardhshme, pjesë e HEC-eve të sipërpërmendura, në pronësi të “Kurum International sh.a.”

- Marrëveshjes së transferimit të të drejtave mbi licencën/at dhe kontratat e projektit dhe çdo të drejtë tjetër të “Kurum International sh.a.” sipas dokumenteve të projektit.

- Marrëveshjes hipotekore mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme të “Kurum International sh.a.” pjesë e (i) HEC-eve të Bisticës 1 dhe Bisticës 2 dhe Ulëz-Shkopet dhe (ii) Fabrikës së Metalurgjisë së Çelikut, Elbasan;

- Marrëveshjes së kolateralit financiar mbi llogarinë bankare në zotërim të huamarrësit në të cilën do të paguhet:

a) të gjitha të ardhurat e sigurimeve të rëna dakord nga palët; dhe

b) të gjitha të ardhurat e pagueshme ndaj huamarrësit sipas dispozitave të projektit;

- Letrës së konfirmimit të ERE-s në përputhje me dakortësimin e palëve në marrëveshjen e kushteve paraprake të datës 19.12.2013, neni 8.16 dhe definicionin që i bëhet kësaj letre në këtë marrëveshje.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë “Kurum International sh.a.” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 8, datë 6.2.2014

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 144, DATË 22.11.2013 “MBI PEZULLIMIN E PROCEDIMIT TË TRANSFERIMIT TË LICENCËS SË PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA “WONDER POWER” SHA TE SHOQËRIA “BHP ENERGY” SHPK

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe urdhrin nr. 3103, datë 31.12.2013, të zyrës përbarimore “TDR Group” sh.p.k., Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 6.2.2014, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 144, datë 22.11.2013 “Mbi pezullimin e procedimit të transferimit të licencës së prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike” nga shoqëria “Wonder Power” sh.a. te shoqëria “BHP Energy” sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 9 datë 6.2.2014

MBI NJË SHITESË NË RREGULLOREN “MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ”, NË ZBATIM TË NENIT 18, PIKA 4/C TË LIGJIT NR. 9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E ENERJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “1” dhe 18, pika 4, germa “c” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij

të datës 6.2.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, lidhur me një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4, germa “c” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 150, datë 30.12.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Mbi prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor”.

2. Të shtojë në nenin 12, pika 4 të rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4 germa “c” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, paragrafin me përmbajtjen si më poshtë:

““CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm, për nevoja të mbulimit të plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të realizojë blerjet e energjisë elektrike mbi baza mujore për sasinë e energjisë elektrike që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor. Për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes mbi baza mujore, administratori zbaton vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 30, datë 23.3.2011 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga “KESH” sh.a.”.”

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “OSSH” sh.a. për vendimmarrjen e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 10, datë 6.12.2013

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KESH” SHA PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË

Në mbështetje të neneve 9; 13, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 7; 149 dhe 150 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të

plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “KESH” sh.a., në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 3.6.2008, me një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM Nr. 11, datë 6.2.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KESH” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; neneve 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “KESH” sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 25.3.2009.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmet**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 48 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006